

TESS

TIRANA ESTHETICS
& STYLE SCHOOL

GUIDA STUDENTORE
2021 - 2022

SFIDO KUFIJTË E KREATIVITETIT BËHU PROFESIONIST

DIPLOMOHU NË PROGRAMET
HAIR ARTIST | MAKE UP ARTIST | ESTETIKË
MENAXHIM | SPA-VE DHE BIZNESIT TË BUKURISË

RRETH TESS

TESS është frymëzuar nga dëshira për ta bërë estetikën dhe të bukurën pjesë të jetës së përditshme, kudo. TESS është shkolla e parë, e vërtetë, e cila krijon profesionistë me njohuri të plota në programet e estetikës, hair artist, make up dhe menaxhim.

Bashkëpunimi me kompanitë e njohura në botë **MAKE UP FOR EVER**, **Davines** dhe **Comfort Zone** dhe me staf të specializuar në make up, estetikë, parukeri, dermatologji, psikologji, ligj, menaxhim, marketing, art dhe fotografi, **TESS** do t'i aftësojë studentët me njohuritë e duhura për t'u bërë profesionistë të suksesshëm. Kolegji Profesional i Lartë **TESS** është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 483, datë 31.07.2019 dhe është i organizuar në dy departamente :

- Departamenti i Estetikë-Nutricionit
- Departamenti i Kozmetologjisë

Programet e Kolegjit Profesional të Lartë TESS janë të licensuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si programe studimi profesionale me kohëzgjatje 1 dhe 2 vite akademike, pas arsimit të mesëm, në përfundim të të cilave do të merrni një **Diplomë Profesionale me 60 ose 120 Kredite ECTS.**



ÇFARË DO TË BËHESH? HAIR ARTIST, ESTETIST, MAKE UP ARTIST APO MENAXHER?

I SPA-ve DHE BIZNESIT TË BUKURISË

Kjo guidë është burimi i detajuar i informacionit që lidhet me profesionin tënd të ardhshëm.



Programi i studimit për estetistët synon të krijojë profesionistë në fushën e estetikës. Roli kryesor i estetistit është të kujdeset për lëkurën dhe kjo mund të arrihet duke pasur një profil të plotësuar në 360 gradë për sa i përket të gjitha njohurive teorike, informacionit që merret nga studimet shkencore, e gjithashtu demostrimeve dhe praktikave në të gjitha disiplinat e fushës.

KOHËZGJATJA

2 VITE AKADEMIKE | 1500 ORË | 4 SEMESTRA

PUNA
SI ESTETISTE

Për ata që pëlqejnë fushën e kozmetologjisë, por duan të specializohen në studimin e kujdesit ndaj lëkurës karriera si estetiste është e duhura.


Pasi diplomohen, studentët punojnë në SPA apo sallone duke i ofruar klientëve trajtime dhe terapi për fytyrën dhe trupin, refleksologji të këmbëve, aromaterapi dhe trajtime me dyllë. Shkolla për estetistë mëson njohjen e problemeve të lëkurës të cilat kanë nevojë për formim në fushën e dermatologjisë.

Një estetiste e mirë duhet të jetë e aftë të punojë dhe të ketë sjellje profesionale. Ajo duhet të ndjehet komod të punojë me klientë një-me-një dhe njëkohësisht duhet ta bëjë klientin të ndjehet i qetësuar dhe i informuar mbi nevojat e kujdesit ndaj lëkurës.

Nevoja për profesionistë në fushën e estetikës është me trend në rritje edhe në vendet e zhvilluara të botës. Punët që mund të kryejë një person me formim si estetist lidhen me shërbimet në sallone dhe spa si estetistë, instruktorë në shkolla për trajnime estetike, zhvillues të linjave të produkteve estetike apo përfaqësues shitje në kompani të cilat tregtojnë produkte të kujdesit ndaj lëkurës.

ÇFARË PËRFITON

DIPLOMË PROFESIONALE | 120 KREDITE ECTS



Programi ka si synim përgatitjen e profesionistëve në këtë fushë duke ofruar një formim të plotë. Programi përfshin njohuri që lidhen me anatominë, flokët e trikologjinë, dhe njohuri që lidhen me aftësitë menaxheriale dhe komunikuese, thelbësore për këtë fushë. Një domosdoshmëri janë edhe njohuritë teorike, demostrimet dhe praktikat lidhur me proceset e flokëve, trajtimet, lyerja dhe prerja të cilat do të studiohen në profilin Hair Artist.

KOHËZGJATJA

2 VITE AKADEMIKE | 1500 ORË | 4 SEMESTRA

PUNA SI HAIR ARTIST

Stilisti i flokëve është profesionisti i pamjes së jashtme i cili pret dhe stilon flokët. Stilistët e flokëve referohen si kozmetologë, edhe pse kozmetologët japin edhe trajtime të tjera si kujdesi për duart apo kujdesi për këmbët.

Stilistët e flokëve përdorin një varietet teknikash stilimi për të ndryshuar apo mirëmbajtur stilin e flokëve të klientëve. Stilistët e flokëve konsultojnë klientin për të përcaktuar nevojat dhe metodën e aplikuar. Pas stilitit ata japin këshilla për mirëmbajtjen e flokëve në shtëpi.

Stilistët e flokëve të cilët hapin sallonet e tyre kanë edhe detyra të tjera të cilat përfshijnë mbajtjen e llogarive, porositë, supervizimin e personelit, për këtë arsye ka nevojë që të trajnohen për mënyrën se si duhet ta marketojnë veten, të krijojnë dhe mbajnë bazën konsumatore.

Stilistët e flokëve mund të punojnë në sallone, në hotele, SPA dhe resorte. Nevojat në rritje për stilistë flokësh do të çojnë në rritje të mundësive të punësimit. Stilistët e flokëve mund të punësohen edhe në industritë e lidhura me imazhin, si për shembull në modelim dhe televizion.

ÇFARË PËRFITON

DIPLOMË PROFESIONALE | 120 KREDITE ECTS



Programi është krijuar për të mundësuar një formim të plotë e gjithë përfshirës për të fituar njohuritë e nevojshme për profesionin Make Up artist. Kjo mund të arrihet duke maksimizuar aftësitë krijuese të studentëve për të qënë përgatitur të plotësojnë të gjitha kërkesat si profesionistë të fushës në nivelet e kërkuara në industrinë e Make Up-it të ditëve të sotme. Programet përfshijnë leksione mbi rëndësinë e studimeve teorike, të kombinuara me demostrime, praktika një-më-një dhe projekte individuale.

KOHËZGJATJA

1 VIT AKADEMIK | 750 ORË | 2 SEMESTRA

PUNA SI MAKE UP ARTIST

Një Make Up artist është profesionisti i cili ndryshon fizionominë e portretit duke nxjerrë në pah bukurinë me një prekje magjike.

Make up artisti e di se si ta bëjë subjektin të duket në formën e tij më të mirë dhe njëkohësisht di si të përshtasë artin në përputhje me kushtet e dritës dhe fototgrafisë dixhitale. Falë aparateve fotografike dixhitale, artistët e Make Up kërkojnë gjithnjë e më shumë në dasma, fotografi mode, evente mode, fotograf personeli e kompanie dhe në ngjarje të tjera të cilat filmohen dhe fotografohen.

Tipi tjetër kryesor i punës si Make Up Artist, është Artist Grimi për teatrin dhe filmin. Në këtë rast artisti bën më të dukshme tiparet e aktorit për të theksuar karakterin që ai ose ajo luan në rolin që performon.

Cilësitë e një artisti të mirë përfshijnë, por nuk janë të kufizuara vetëm tek: shërbim i shkëlqyer ndaj klientit, kreativitet, vetë-motivim, menaxhim i mirë i kohës, të kuptuarit të artit dhe dizajnit, dëgjues i mirë, komod në rekomandime dhe aftësi për të parë detajet.

ÇFARË PËRFITON

DIPLOMË PROFESIONALE | 60 KREDITE ECTS

PROGRAM STUDIMIT

MENAXHIM

I SPA-VE DHE BIZNESIT TË BUKURISË



Programi Menaxhimi i SPA dhe biznesit të bukurisë synon të përmbushë nevojën për personel të specializuar në këtë fushë me qëllim përmirësimin e performancës së bizneseve të qendrave të bukurisë, SPA-ve dhe sektorit të lidhur me to; atij hotelier dhe turizmit. Si një menaxher SPA-je do të duhet të formoheni lidhur me menaxhimin financiar, komunikimin në marketing, etikë, marëdhënien profesionale me klientet, Arkitekturën e SPA-së, dizajnin dhe pajisjet.

KOHËZGJATJA

2 VITE AKADEMIKE | 1500 ORË | 4 SEMESTRA

PUNA SI MENAXHER

Zhvillimi dhe rritja e numrit të hoteleve ka shtuar edhe numrin e qendrave SPA të integruara me hotelet, përveç atyre të cilave operojnë si njësi shërbimi të veçuara. Për këtë, nevoja për staf të specializuar është e madhe.

Të diplomuarit në Menaxhimin e SPA-ve dhe biznesit të bukurisë gjejnë karriera në role menaxheriale të SPA-ve dhe resorteve me pesë yje. Ata janë pjesë e skuadrave drejtuese dhe menaxhuese të bizneseve të bukurisë. Janë përgjegjës për menaxhimin e të gjitha pjesëve operacionale të SPA-së, menaxhimit të stafit dhe buxheteve si dhe qëllimi kryesor është të sigurohen që klientët të kenë eksperiencën më të mirë të mundshme duke gjetur metoda të reja e inovative për t'u përmirësuar.

Në vazhdimësi të menaxhimit të SPA-ve ka edhe role të tjera menaxhuese në këtë industri si asistent menaxher, menaxher i trajtimeve dhe menaxher i operacioneve. Në kompani edhe më të mëdha mund të ketë edhe nivele menaxhuese më të larta si ato të menaxhimit të një zone ose rajoni.

ÇFARË PËRFITON

DIPLOMË PROFESIONALE | 120 KREDITE ECTS

ME ÇFARË PAJISEM NË FUND TË CIKLIT TË STUDIMIT?



DIPLOMË PROFESIONALE E AKREDITUAR

Në përfundim të programeve Estetikë, Hair Artist, Make Up Artist dhe Menaxhim i SPA-ve, studentët tanë do të pajisen me DIPLOMË PROFESIONALE të miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Këto diploma janë me 60 ose 120 Kredite ECTS.

Profili Make Up është program 1-vjeçar dhe diploma lëshohet me përfundimin dhe përvetësimin e të gjithë lëndëve të kurrikulës. Diploma në profilin Estetikë, Hair Artist dhe Menaxhim i SPA-ve, do të kryhet në përfundim të kurrikulës 2 vjeçare.

KREDITE ECTS

120 | 60

CILAT JANË KRITERET E PRANIMIT?

- Mosha mbi 18 vjeç
- Diplomë e Maturës Shtetërore

Programet e studimit janë tv përshtatshëm për të gjithë ata që kanë interes për fushën e estetikës, Make Up-it, parukerisë dhe menaxhimit.

- Për maurantët që kanë plotësuar formularin A2 ose A1Z: Regjistrimi bëhet përmes portalit U-Albania.

Dokumentacioni që duhet dorëzuar në momentin e regjistrimit :

- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës
- Fotokopje të noterizuara e diplomës/dëftesës të gjimnazit dhe certifikatës së notave (ose diplomës së Universitetit të parë)
- Mandat pagesa e tarifës së shkollës

KENI PYETJE?

Për pyetje ose informacione të tjera na kontaktoni në:
Facebook | TESS-Tirana Esthetics&Style School **Instagram** | @tess.albania
e-Mail | info@tess.al **CEL** | +355694000014 | +355694000113



Rruga "Gjeneral Nikols" Pallati Shushica,
Kati i parë, Tiranë, Shqipëri.

PARTNERËT KRYESORË

Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe e Projekteve ka si objektiv rritjen e marrëveshjeve institucionale me partnerë rajonal dhe botërorë.

Qëllimi i Kolegjit Profesional TESS, është krijimi i mjedisit akademik ndërkombëtar dhe rritja e numrit të studentëve dhe stafit akademik të përfshirë në programet e lëvizshmërisë.

Gjithashtu, në qëllimin e Kolegjit është edhe promovimi i bashkëpunimit me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, me qëllim shkëmbimin e përvojës, kapaciteteve kërkimore dhe zhvillimore.

Marrëveshjet institucionale të realizuara deri më tani përfshijnë kompani si dhe institucione kombëtare dhe ndërkombëtare si Davines, Comfort Zone dhe MAKE UP FOR EVER.



PROJEKTE

Mëso më shumë mbi projektet duke vizituar faqen tonë www.tess.al/projekte ose na kontaktoni ne email-in: projects@tess.edu.al

TESS ofron kurse profesionale të licensuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë që prej vitit 2017 në fushat:

- MAKE UP
- ESTETIKË
- PARUKERI
- MENAXHIM
- KOMUNIKIM MARKETING
- FOTOGRAFI
- DIZAJN
- MASAZHERI

AKREDITIMET TESS

Kolegji Profesional i Lartë **TESS** është akredituar nga **Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë**, si një Institucion i Arsimit të Lartë, në nivel institucional me Vendim të Bordit të Akredimit nr. 04, datë 24/01/2020.

Programi "Make Up Artist" është akredituar me Vendim të Bordit të Akredimit nr. 19, datë 24/01/2020, me vlerësim maksimal për 6 vite.

Programi "Hair Artist" është akredituar me Vendim të Bordit të Akredimit nr. 55, datë 27/11/2020, me vlerësim maksimal për 6 vite.

Programi "Estetikë" është akredituar me Vendim të Bordit të Akredimit nr. 56, datë 27/11/2020, me vlerësim maksimal për 6 vite.

Programi "Menaxhimi i SPA-ve dhe biznesit të bukurisë" është licensuar me Urdhër të Ministrit nr. 237, datë 19/07/2021.

Programet e Kolegjit Profesional të Lartë **TESS** janë të licensuara nga **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë** si programe studimi profesionale me kohëzgjatje 1 dhe 2 vite akademike.